



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 272/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas nenit 23 të Rregullores së Punës së OSHP-së përkitazi me ankesën e parashtruar nga operatori ekonomik: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik, më datën: 11.06.2020, mori këtë:

U R D H Ë R E S Ë

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik.

III. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik që të zbatoj vendimet e OSHP-së me numër PSH.nr.100-111/2020, i protokolluar me datë 18.03.2020, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik.

IV. URDHËROHET, Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe operatorin ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, lidhur me zbatimin e vendimeve të OSHP-së me numër PSH. nr. 100-111/2020, i protokolluar me datë 18.03.2020, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej 5 ditë kalendarike, do ta detyroj Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e

licencës për menaxherin e prokurimit të Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, aprovohet si e bazuar të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.04.2020 me nr. 272/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Junik, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 24, 51, 56, 59, 60, 68, 69, 72 dhe nenin 80 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.05.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues Joos Krasniqi: Sa i përket arsyes së parë të eliminimit, që ka të bëjë me kërkesën nr. 3 të gjendjes ekonomike dhe financiare, për të cilën OE ankues pretendon se e plotëson me arsyetimin se në ofertë e kemi dorëzuar dëshminë me numër: MDI 1923400003 të lëshuar nga Raiffeisen Bank, me të cilën është garantuar mbështetja financiare në vlerë prej: 300,000.00 euro. Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se në dosje të tenderit nuk është kërkuar letër mbështetje nga banka për vlerën e kërkuar, por para të gatshme. Prandaj, AK-ja

me të drejtë ka vlerësuar se i njëjti nuk e plotëson kërkesën me nr. 3 tek gjendja ekonomike dhe financiare, sepse AK-ja ka kërkuar, citat: Kërkesa: Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00€. Dëshmia: Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE ka mjetet financiare të gatshme sipas kërkesës.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit, që ka të bëjë me kërkesën nr. 9 të kapacitetit teknik dhe profesional, për të cilin pretendon i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se kjo arsye e njëjtë e eliminimit është trajtuar edhe më parë, prandaj e konsideron si çështje të gjykuar, për faktin se është sqaruar se dëshmitë e lëshuara nga banka për mbi 50 punëtorët e kërkuar nga AK-ja, nuk është e vulosur, por fakti që i njëjti operator ekonomik e ka dorëzuar listën e ATK-së dhe listat e Administratës Tatimore të Shqipërisë, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se i njëjti i ka mbi 50 punëtor në gjashtë mujorin e fundit. Prandaj, ky pretendim qëndron.

Lidhur me arsyen e eliminimit, që ka të bëjë me pajisjet, ku AK-ja e përmend faktin se OE ankues nuk ka dorëzuar dëshmitë për një buldozher D7 i kërkuar në dosje të tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar buldozher D5, D150 dhe D10 Cater Pillar Cat 953. Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së për pajisjen e lartpërmendur.

Sa i përket pajisjeve tjera: Autopomp e betonit, Autobetonjerk - mikser dhe autocisternë, për të cilat AK-ja në arsyetimin e dhënë është deklaruar se dëshmitë janë të pa identifikueshme, eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e OE ankues janë disa dëshmi të cilat janë të palexueshme, mirëpo eksperti shqyrtues vlerëson se nuk mund të vlerësohet si mos përmbushje e një kërkesë fakti që një dokument është i palexueshëm, pa një verifikim të atij dokumenti sipas nenit 72 të LPP-së. Po ashtu, sa i përket pajisjes për gërryerjen e asfaltit për të cilën AK-ja është deklaruar se i mungon dudi doganor, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në listën e pajisjeve e ka deklaruar gërryesen e asfaltit dhe për të njëjtën ka ofruar faturën e blerjes. Sa i përket arsyetimit të AK-së lidhur me kërkesën nr. 13 të kapacitetit teknik dhe profesional, eksperti shqyrtues e konsideron si çështje të gjykuar për faktin se për të njëjtin pretendim OE ankues ka ofruar prova në seancën e parë. Lidhur me pretendim e OE ankues se AK-ja, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka caktuar anëtar të komisionit persona të njëjtë të cilët kanë qenë edhe në vlerësimet tjera si anëtar të komisionit. Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim qëndron pjesërisht për faktin se dispozitat e LPP-së nuk e rregullojnë një situatë të tillë por që praktik ka qenë që anëtarët të jenë të ndryshëm, mirëpo duhet pas parasysh faktin që kjo lëndë është në rivlerësim që disa herë. Në fund eksperti shqyrtues vlerëson se pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara më lartë, në rastin e

kërkesën për mbi 50 punëtorët dhe dokumenteve të pa identifikueshme të cilat AK-ja është dashur ti verifikoj, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar për faktin se OE Joos Krasniqi nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 3 të kapacitetit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe kërkesën nr. 10 në lidhje me buldozherin D7.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si të pabazuara, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 22.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konfirmon nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të eksperteve shqyrtues/teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.p.k-Junik që ka të bëjë me arsyen e eliminimit lidhur me kërkesën nr. 3 të gjendjes ekonomike dhe financiare, për të cilën OE ankues pretendon se e plotëson me arsyetimin se në ofertë e kemi dorëzuar dëshminë me numër: MDI 1923400003 të lëshuar nga Raiffeisen Bank, me të cilën është garantuar mbështetja financiare në vlerë prej: 300,000.00 euro, paneli shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar para të gatshme në shumë prej 300,000.00 euro kurse OE ankues në dosje të tenderit ka dorëzuar dokumentin me numër: MDI 1923400003 të lëshuar nga Raiffeisen Bank me të cilën është garantuar mbështetja financiare në vlerë prej 300,000.00 euro. Pra, Paneli Shqyrtues sqaron se dokumenti në fjalë dëshmon që banka

Raiffeisen ka lëshuar këtë dokument për mbështetje në shumë prej 300,000.00 euro dhe është e barabartë me kërkesën e AK-se lidhur me disponueshmërinë e shumës së kërkuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik që ka të bëjë me arsyen e eliminimit sa i përket kërkesës nr. 9 të kapacitetit teknik dhe profesional, për të cilin OE pretendon i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo arsye e eliminimit është trajtuar edhe më parë dhe është sqaruar se dëshmitë e lëshuara nga banka për mbi 50 punëtorët e kërkuar nga AK-ja nuk është e vulosur, por fakti që i njëjti operator ekonomik e ka dorëzuar listën e ATK-së dhe listat e Administratës Tatimore të Shqipërisë, konsiderohet se OE ankues ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se i njëjti i ka mbi 50 punëtor në gjashtë mujorin e fundit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik që ka të bëjë me pajisjet tjera sikurse: Autopomp e betonit, Autobetonjerk - mikser dhe autocisternë, për të cilat AK-ja në arsyetimin e dhënë është deklaruar se dëshmitë janë të pa identifikueshme, Paneli Shqyrtues se këto pretendime ankimore janë shqyrtuar më parë dhe për të njëjtat është vendosur se janë të bazuara, andaj paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet të veproj konform vendimeve parakrake. Po ashtu, sa i përket pajisjes për gërryerjen e asfaltit për të cilën AK-ja është deklaruar se i mungon dudi doganor, Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në listën e pajisjeve e ka deklaruar gërryesen e asfaltit dhe për të njëjtën ka ofruar faturën e blerjes. Ndërsa lidhur me arsyetimin e AK-së që ka të bëjë me kërkesën nr. 13 të kapacitetit teknik dhe profesional, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues e konsideron si çështje të gjykuar për faktin se për të njëjtin pretendim OE ankues ka ofruar prova në seancën e parë.

Lidhur me pretendim e OE ankues "Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik se AK në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka caktuar anëtar të komisionit persona të njëjtë të cilët kanë qenë edhe në vlerësimet tjera si anëtar të komisionit, Paneli Shqyrtues sqaron se edhe për këtë sikurse për të gjitha pretendimet e lartcekura është vendosur nga paneli shqyrtues dhe AK është e obliguar që të veproj konform vendimit të cekur si në diapozitiv të këtij vendimi.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, vendimin e mëhershëm të Panelit Shqyrtues PSH.nr.100-111/2020, i protokolluar me datë 18.03.2020, vlerëson se AK e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Paneli shqyrtues sqaron se të gjitha pretendimet e OE ankues janë sqaruar në vendimet paraprake të panelit shqyrtues, andaj AK obligohet që të veproj në harmoni me ato vendime dhe vërejtjet

e dhëna në vendimin e mëhershëm. Mos respektimi i vendimit të OSHP-së nga autoriteti kontraktues, detyron Panelin Shqyrtues që të ndërmerri veprime ligjore konform LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të kësaj urdhërese.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Urdhëresa t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Junik

1x1 OE - "Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k-Junik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.